



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 546/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi duke vendosur përkitazi me ankesat e Lidhjës Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Drenac paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Deçan, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohen** si të pabazuara ankesat e Lidhjës Demokratike të Kosovës (LDK) në Drenac me Anr. 546/2013 dhe Anr. 547/2013.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar dy ankesa më datë 04.11.2013, nga subjekti politik LDK dega në Deçan, dhe me natyrë te njejtë të shkeljeve në të cilat theksohet se me datën 03.11.2013, në ora 14:35, në qendrën e votimit në Deçan në shkollën Fillore "Syl Alaj", 0102C, menaxheri i qendrës i cili është edhe drejtor i shkollës Zeqir Nitaj në bashkëpunim me militant të AAK-së në hyrje dhe përgjatë korridorit është duke bërë presion në votues. Parashtruesi i ankesën thekson se janë shkelur dispozitat ligjore nga neni 34.2 lidhur me ninin 33 pika G) te LZP -së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesat gjeti se:

Me ninen 118.4 të LZP-së, parashihet se "Mund të apelohet vendimet e PZAP-it sikurse PZAP-i, mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar".

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 te Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që

gjenden në shkresa të lendes, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

**Ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet ankimore nga ankesat e subjektit politike Lidhjës Demokratike të Kosovës Dega në Deçan se janë bërë shkeljet e theksuara nga radhët e subjektit politike AAK-së, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës fillore Zeqir Nitaj, i cili ka bërë presion në hyrje dhe përgjatë korridorit, janë të pabazuara, pasiqë dëshmitë e ofruara janë të përgjithshme dhe të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen pretendimet ankimore.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar parregullsi nga vëzhguesit e subjektit të lartcekur, PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara.Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresë**

Anr. 546/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**



***Këshillë Juridike:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda njëzetekatër (24)orë nga moment i marrjes së këtij vendimi nga PZAP-i.